



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”

SHEMBUJ VENDIMESH TË NJËSIVE

KRYESORE

NË

UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ”





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI EKONOMIK

Nr 86 Prot.

Gjirokastrë, më 06.11.2020

VENDIM

Nr. 08, datë 06.11.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË RENDITJES SË KANDIDATËVE TË CIKLIT TË
DYTË TË STUDIMIT NË FE.

Dekanati në mbledhjen e tij të datës 06.11.2020 vendosi kriteret e vlerësimit për kandidatët e ciklit të dytë të studimeve si më poshtë:

1. Kandidatët të renditen mbi bazën e mesatares të ciklit të parë të studimit (Bachelor).
2. Në rast se dy kandidatë kanë mesatare të njëjtë dhe kur numri i aplikantëve është më i madh se plani të llogaritet mesatarja e shkollës së mesme.

Konceptoi: Fabjola Sinani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI EKONOMIK

Nr. 54/1 Prot.

Gjirokastër, më 12 / 10 / 2019

VENDIM

Nr. 02 , datë 12 . 10 . 2019

PËR

NGRITJEN E KOMISIONIT ad - hoc PËR VLERËSIMIN E DOSJEVE TË APLIKANTËVE
PËR REGJISTRIM NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE PRANË "FE"
PËR VITIN AKADEMIK 2019 - 2020

Mbështetur në Udhëzimin nr. 17 datë 30. 07. 2019 , me nr. 7655/1 Prot. të MASR-së " Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10 datë 15.05.2019, Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë " Kreu IV/4 , pika 12 për ngritjen e komisionit "ad-hoc", për vitin akademik 2019 - 2020, si dhe në mbledhjen e Dekanatit më datë 12.10.2019, u vendos:

Ngritja e komisionit ad - hoc me këtë përbërje:

- | | | |
|--------------------------|-----------------------------------|-----------|
| 1. Doc. Dr Etleva Peta | (Kontabilitet Finance) | - kryetar |
| 2. Doc. Dr. Alketa Bejko | (Administrim Publik) | - anëtar |
| 3. Dr. Daniela Qiqi | (Politikat Ekonomike dhe Turizmi) | - anëtar |
| 4. Dr. Belinda Xarba | (Kontabilitet Finance) | - anëtar |
| 5. Dr. Drita Luzo | (Politikat Ekonomike dhe Turizmi) | - anëtar |

Zv. DEKAN

Dr. Robert ÇELO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

FAKULTETI EKONOMIK

Gjirokastrë, më 22.05.2018

VENDIM
Nr.08, datë 22.05.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 75, 76 të tij, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Udhëzimit të MASR-it nr.31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 20 pika 3, Dekanati i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e tij të datës 22.05.2018, diskutoi rreth kërkesës së Departamentit të Kontabilitet-Financës për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Financë -Kontabilitet", 2 vite akademike (120 ECTS) dhe me votim unanim:

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Financë -Kontabilitet", 2 vite akademike (120 ECTS).
2. T'i propozojë Senatit Akademik të Universitetit "Eqrem Çabej", hapjen e këtij programi studimi.

DEKAN

Prof. Asoc. Ermonela RUSPI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE**

Nr. 64 Prot

Gjirokastër, më 27.10.2020

V E N D I M

Nr. 7, datë 27.10.2020


Në mbështetje të Vendimit nr 41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" pika 2.9 Profili i programit, gërma c, të vendimeve të Njësive Bazë përkatëse, Dekanati i F.E.SH.SH.-së në mbledhjen e tij të datës 27.10.2020 vendosi të miratojë propozimet e Njësive Bazë për riorganizim planesh e programesh si më poshtë:

1. Plan mësimor në "Master Profesional Mësuesi Ndihmës në Edukim Gjithpërfshirës"
2. Plan mësimor në "Edukatorë për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijërisë së Hershme (0-3 vjeç).
3. Plan mësimor në "Bachelor Histori dhe Gjuhë Italiane"
4. Plan mësimor në "Master i Shkencave në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike"
5. Plan mësimor në "Udhërrëfyes Turistik"
6. Plan mësimor në "Master Mësuesi në Biologji Kimi"

**DEKANI
Prof.dr. Gëzim SALA**

KONCEPTOI:
Laureta B EDAJ

Rruga "Studenti" Lagja "18 Shtatori", Gjirokastër 6001, Tel: 084263408 Fax: 084263409 Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al



REPUBLICA ESHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCËVE SHOQËRORE

Nr. S1 Prot.

Gjirokastër, më 12.10 2019

V E N D I M

Nr. 04, datë 12.10.2019

P Ë R

**NGRITJEN E KOMISIONIT ad - hoc PËR VLERËSIMIN E DOSJEVE TË APLIKANTËVE
PËR REGJISTRIM NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE PRANË
FESHSH PËR VITIN AKADEMIK 2019 - 2020**

Mbështetur në Udhëzimin nr. 17 datë 30. 07. 2019 , me nr. 7655/1 Prot. të MASR-së " Për disa shtesa dhe ndryshime ne udhëzimin nr. 10 datë 15.05.2019, Për procedurat e aplikimit dhe te regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë " Kreu IV/4 , pika 12 për ngritjen e komisionit "ad-hoc", për vitin akademik 2019 - 2020, si dhe në mbledhjen e Dekanatit më datë 12.10.2019, u vendos:

Ngritja e komisionit ad - hoc me këtë përbërje:

- | | |
|--|-----------|
| 1. Prof.Dr Gëzim Rredhi | - kryetar |
| 2. Prof.Asoc Jaho Cana, Prof.Asoc Albina Sinani (Histori-Gjeografi) | - anëtar |
| 3. Prof.Asoc Harallamb Miçoni, Dr. Manjola Sulaj (Gjuhët e Huaja,) | - anëtar |
| 4. Prof.Asoc Sadik Malo, Prof.Dr Lavdi Hasani (Biologji-Kimi) | - anëtar |
| 5. Dr. Dhori Terpo , Dr. Kastriot Zoto (Mat-Inf, Mat-Fiz) | - anëtar |
| 6. Prof.Asoc Spiridhulla Poçi, Prof. Asoc Merita Shehu (Gjuhë-Letërsi) | - anëtar |
| 7. Dr. Mimoza Çarka, Dr. Lori Mamani (Arsim Fillor) (Mësues Ndihmës) | - anëtar |
| 8. Prof.Asoc. Panajot Barka, Dr. Kostando Ksera (Gjuhë Letërsi dhe Qyt Grek) | - anëtar |

D E K A N

Prof. dr GËZIM SALA







REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE

Gjirokastrë 03. 05. 2018

V E N D I M

Nr. 1 datë --- 03.05.2018

DEKANATI i Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në Universitetin "Eqrem ÇABEJ" të Gjirokastrës, në mbledhjen e datës 03.05.2018, miratoi Vendimin e Departamentit të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies për **hapjen e programit të studimit të nivelit të dytë me kohë të plotë "Master profesional" në "Mësuesi për arsimin fillor klasa I-V"**, në mbështetje të neneve 100, 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve **35,70, 71, 83 pika 1.a),b)** të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Referuar Statutit të Universitetit "Eqrem ÇABEJ", Gjirokastrë (2016), neni **20**. Referuar Kornizës Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë (2014)

Nga verifikimi i kryer rezulton se dokumentacioni bashkëshoqërues i Departamentit të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies është plotësuar sipas kriterëve të dhëna në udhëzimin **Nr. 31** datë 29.12.2017 të MASR, "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", të Vendimi **Nr.41**, datë 24.01.2018 të MASR "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"

Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë "**Master Profesional**".

DEKANI

Prof. dr. Gëzim SALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
GJIROKASTËR

Nr. 1428 Prot.

Gjirokastër, më 15.12.2020

VENDIM

NR. 8 DATË 15/12/2020

PËR

MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
ME KARAKTER PROFESIONAL: "MENAXHER MJEDISI"

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 72; VKM nr.879 dt.18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.41 dt.24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të"; Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 të MASR për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, Njësive Kryesore dhe Programeve të Studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, neni 20 pika 3; Vendimit të Njesisë Bazë të Biologji-Kimisë nr.1 dt.01.12.2020; Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Natyrës në mbledhjen e tij të dates 15.12.2020 diskutoi rreth propozimit të Departamentit të Biologji-Kimisë për hapjen e programit me karakter profesional "Menaxher mjedisi", 2-vjeçar (120 kredite).

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur i cili ishte në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të sipërpërmendura, Dekanati me votim unanim:

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të studimit me karakter profesional "Menaxher mjedisi" 2-vjeçar.
2. T'i propozojë Senatit Akademik të Universitetit "Eqrem Çabej" hapjen e këtij programi studimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DEKAN

Prof. asoc. Dr. Selfo Oruçi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Nr. 329 Prot.

Gjirokastrë, më 29.05.2018

V E N D I M

Nr. 4, datë 29.05.2018

P Ë R

PROJEKT PROPOZIMET NË FUSHËN E KËRKIMIT SHKENCOR PRANË
FSHN-së

Në mbështetje të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" Neni 93 pika 1, Neni 95 pika 1; në Statuti e UGJ-së Neni 36 si dhe në thirrjen e hapur për projekt propozime në fushën e kërkimit shkencor nga Universiteti i Gjirokastrës si dhe bazuar dhe në Vendimin Nr. 66 Prot. datë 25.05.2018 të Njesisë Bazë/ Departamentit të Biologji-Kimisë; Dekanati mori në shqyrtim Draft -Projektet Shkencore e paraqitura dhe;

V E N D O S I:

Të miratojë **Draft-Projektet Shkencore** të propozuara nga Njësia Bazë/ Departamenti i Biologji-Kimisë si më poshtë:

1. Studimi taksonomik dhe mjedisor i gjinive *Crocus*, *Stachys*, *Centaurea* dhe *Solenanthus* në Malet e Çajupit, Nemërçkës (pjesa e Permetit) si dhe Konispolit (Sarandë) e Lumit të Vlorës.
2. Studimi i dietës ushqimore të shpendëve rrëmbenjës të natës *Tyto alba* dhe *athene noctua* në rajonin jugor të shqipërisë (prefektura e Gjirokastrës dhe Vlorës)".
3. Vlerësimi, Konservimi dhe plotësimi i elementeve të Biodiversitetit të fushës arkeologjisë së Antigonesë (pikës arkeologjike dhe rrethinat e saj.)



Zyra e Dekanit
Tel.&Fax.00355 842 68028





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
GJIROKASTËR

Nr. 51 Prot.

Gjirokastrë, më 24.01.2019

V E N D I M

Nr. 1, datë 24.01.2019

P Ë R

**KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
DHE TË DYTË PRANË FSHN-së PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021;**

**KUOTAT E PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
DHE TË DYTË PRANË FSHN-së PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020**

Mbështetur në propozimet e Përgjegjësve të Njësive Bazë të programeve që mbulojnë, si dhe në mbledhjen e Dekanatit të datës 24.01.2019,

VENDOSI:

1. Të miratojë për programet e ciklit të parë si kriter bazë ndarjen 50% (nota mesatare e përgjithshme aritmetike e tre viteve të shkollës plus Matura Shtetërore) me 50% (lëndët e përcaktuara nga fakultetet) për vitin akademik 2020-2021.
2. Të miratojë për programet e ciklit të dytë si kriter notën mesatare të studimeve të ciklit të parë ≥ 7 (shtatë) për vitin akademik 2020-2021.
3. Të miratojë kuotat e pranimit për ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2019-2020.

DEKAN

Prof. asoc. Dr. Selfo Oruçi

